



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 59, datë 30.04.2024

**PËR
MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË RREGULLOREN NR. 38, DATË 31.03.2023,
“PËR REGJISTRIMIN E AGJENTIT TË SHITJES SË SIPËRMARRJEVE TË
INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME PJESËMARRJE TË HAPUR ME OFERTË
PUBLIKE NË TITUJ TË TRANSFERUESHËM TË MIRATUARA NË NJË VEND
ANËTAR TË BE-SË”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e disa shtesave në rregulloren nr. 38, datë 31.03.2023 “Për regjistrimin e agjentit të shitjes së sipërmarrjeve të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të miratuara në një vend anëtar të BE-së”, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohen Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI**

Në rregulloren nr. 38, datë 31.03.2023, “Për regjistrimin e agjentit të shitjes së sipërmarrjeve të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të miratuara në një vend anëtar të BE-së”, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në fund të titullit të rregullores, shtohen fjalët “dhe të fondeve të investimeve alternative të themeluara në një vend anëtar të BE-së”.

Neni 2

Në fund të nenit 1, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje: “Gjithashtu, kjo rregullore ka si qëllim përcaktimin e kërkesave për regjistrimin e personave juridikë që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e marketimit dhe shitjes së aksioneve ose kuotave të fondeve të investimeve alternative (FIA), vetëm për klientë profesionistë dhe të kualifikuar të themeluar në një shtet anëtar të BE-së dhe të regjistruar nga Autoriteti”.

Neni 3

Në nenin 2, pas fjalëve “të neneve 101 dhe 102”, shtohen fjalët “dhe pikës 2, shkronja “e” të nenit 156”.

Neni 4

Në nenin 4, në paragrafin e parë, pas fjalës “Autoriteti” shtohen fjalët “ose të FIA të themeluara në një vend anëtar të BE-së dhe të regjistruara nga Autoriteti”.

Neni 5

Në nenin 5, pika 1:

- në shkronjën “b”, pas fjalëve “shoqërinë administruese të SIK”, shtohen fjalët “/administruesin e FIA”;
- në shkronjën “e”, pas fjalës “Autoriteti”, shtohen fjalët “ose FIA të themeluara në një vend anëtar të BE-së dhe të regjistruara nga Autoriteti”;
- në shkronjën “f”, në nëndarjet “ii”, “iii”, “iv” pas fjalës “SIK” shtohet fjala “/FIA”.

Neni 6

Në nenin 6:

- në pikën 1, pas fjalëve “të sipërmarrjes së investimeve kolektive”, shtohen fjalët “fondeve të investimeve alternative”.

- në pikën 2:
- paragrafi i parë, pas fjalës “SIK” shtohet fjala “/FIA”;
 - në shkronjën “d”, pas fjalëve “sipërmarrje të investimeve kolektive (SIK)” shtohen fjalët “fond të investimeve alternative (FIA)” dhe pas fjalëve “shoqërisë administruese të SIK” shtohen fjalët “/administruesit të FIA”;
 - në shkronjën “e”, pas fjalëve “në sipërmarrjet e investimeve kolektive (SIK)”, shtohen fjalët “/fondet e investimeve alternative”;
 - në pikat 3, 4, 5, 7 dhe në nenin 7, pika 1, shkronjat “a”, “b”, “c” pas fjalës “SIK” shtohet fjala “/FIA”;
 - në pikën 6, pas fjalëve “shoqërinë administruese të SIK” shtohen fjalët “/administruesin e FIA” dhe pas fjalës “SIK” shtohet fjala “/FIA”.

Neni 7

Kudo në rregullore fjala “SIK”, zëvendësohet me fjalët “SIK me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm”.

Neni 8

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.